

N. 6306

BASHKIA FIER

13.10.2026

KËSHILLI BASHKIAK

PROJEKT- VENDIM

Nr. 52, datë 13/10/2026

Për disa shtesa dhe ndryshime në VKB nr. 109, datë 27.11.2025 "Mbi strukturën, nivelin e taksave dhe tarifave vendore të Bashkisë Fier për vitin 2026 "

Mbështetur në Ligjin nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", gërma "f" e ndryshuar, të nenit 54; Ligjin nr. 9632, datë 31.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar; Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar; Udhëzimin nr. 24, datë 02.09.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar; Ligjin nr. 68/2017, "Për financat e vetëqeverisjes vendore"; Ligjin nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë"; Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 132, datë 07.03.2018, "Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme 'ndërtesa, bazën e taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kriterëve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës", i ndryshuar me VKM nr. 144, datë 13.02.2020; Ligjin nr. 9975, datë 28.07.2008, "Për taksat kombëtare", i ndryshuar; Ligjin nr. 107/2014, "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit"; ndryshuar; Rregullores së Këshillit Bashkiak Fier Neni 91,92,93; Dëgjuesën publike të zhvilluar më datë ___/___/2026 dhe procesverbalin e dëgjuesës publike nr. _____ prot, datë _____,

Propozon :

Në VKB nr. 109, datë 27.11.2025 "Mbi strukturën, nivelin e taksave dhe tarifave vendore të Bashkisë Fier për vitin 2026 ", të bëhen ndryshimet si më poshtë vijon:

1. Në tabelën nr. 5 "Niveli i taksës së ndikimit në infrastrukturë sipas kategorive dhe zonave", pika 2 gërmat "b", "c" dhe "d" ndryshohen si më poshtë :

Objekte për qëllime banimi apo njësi tregtimi dhe shërbimi, të kryera nga shoqëri ndërtimi - llogaritet me çmimin e shitjes për m² x %				
a) Objekt njëkatësh	4%	4%	4%	4%
b) Objekte 2-3 kate	4%	4%	4%	4%
c) Objekte mbi 4 kate	4%	4%	4%	4%
d) Objekte për qëllime shërbimi	4%	4%	4%	4%

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi të gjitha Drejtoritë përkatëse dhe strukturat e ngarkuara për arkëtimin dhe faturimin e taksave dhe tarifave vendore.

Kryesia e Këshillit Bashkiak

1-Melsi Bogdani

2-Arben Çuko

3-Fatbardha Merkaç

4-Marjus Voja

5-Kreshnik Dapi

6-Endri Jaupaj

7-Rrapi Gjika

